

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **613-26-1259-2-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**GASHI EG SH.P.K**

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

**Rr - Oerim Banulla , nr - 16**

*(Adresa)*

**Lipjan**

*(Vendi)*

**14 000**

*(Kodi postar)*

**+38344371604**

*(Numri Telefonit)*

**N/A**

*(Numri i Faks-it)*

**Egzon GASHI**

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

**gashi.eg20@hotmail.com**

*(Adresa elektronike)*

**25.05.2026**

*(Data e parashtrimit të ankesës)*

*(Nënshkrimi dhe vula)*

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.



## 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 17.03.26  
B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara: 20.03.26  
Data e hapjes së ofertave dt. 08.04.26  
Njoftimi mbi vendimin e AK-së 1: 30.04.26  
Njoftimi mbi vendimin e AK-së 2: 08.05.26  
Vendimi për refuzim të kërkesë për rishqyrtim: 15.05.26

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së  
Neni 6 i LPP-së  
Neni 7 i LPP-së  
Neni 59 i LPP-së  
Neni 60 i LPP-së  
Neni 62 i LPP-së  
Neni 40 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik  
Neni 43.5 dhe 43.7 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik  
Neni 45 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik

\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkëlqen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Të nderuar, ne me dt. 08.05.2026 ne platformën elektronike të prokurimit kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së 2 me arsyetimin e mëposhtëm:

Komuna Lipjan anulon këte aktivitet të prokurimit për arsye se:

Paramasa nga njësia e kërkesës është formuluar gabimisht dhe gjatë fazës së rivlerësimit pas pranimit të një kërkesë për Rishqyrtim, gjatë Rivlerësimit AK ka konsideruar që paramasa është formuluar në atë mënyrë që tek Operatorët Ekonomik ka krijuar hamendësim gjatë dorëzimit të ofertave, gjithashtu vlenë të theksohet se gjatë fazës sa ka qene e hapur NJK nuk kemi pasur asnjë kërkesë për rishqyrtim apo ndonjë kërkesë për Sqarime në DT dhe tek përshkrimi i cmimeve.

Në këtë rastë tek përshkrimi teknik (paramasa) grupacioni 2 pozicioni nr 2.2, vije në kundërshtim me kërkesat e AK pasi paraqitën në specifikacionin e kërkuar në DT, deklarata e dorëzuar nuk janë në harmoni me paramasën nisur nga kjo është krijuar një konfuzion pasi që i bije që për qdo bartje apo largim të automjetit AK do të paguaj apo shpenzoj nga mjetet e veta, që faktikisht kishte me qenë obligim i pronarëve të automjeteve dhe OE, sepse ky pozicion gjindet në paramasë i cili ka cmim i plotësuar nga të gjithë OE.

Nisur nga ky aspekt AK nuk ka kapacitete financiare që për qdo parking i cili kalon 24 orë të marrë përgjegjësi të paguaj nga buxheti komunës.

Fillimisht ju sqarojmë se se arsyetimi i dhënë nga AK për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit është i paqëndrueshëm, i pabazuar në fakte dhe në kundërshtim me dispozitat dhe parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Komuna e Lipjanit bën anulimin e aktivitetit të prokurimit për arsye të mëposhtme:

Lidhur me pretendimet e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Mirëmbajtja e parkingut nëntokësor”, me nr. të prokurimit 613-26-1259-2-2-1, konsiderojmë se arsyetimi i dhënë është i pabazuar dhe në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik.

Së pari, Autoriteti Kontraktues pretendon se paramasa është formuluar gabimisht dhe se ka krijuar hamendësim tek Operatorët Ekonomik gjatë dorëzimit të ofertave. Megjithatë, duhet theksuar se gjatë gjithë periudhës së publikimit të Dosjes së Tenderit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për sqarim, asnjë kërkesë për ndryshim të Dosjes së Tenderit dhe asnjë kërkesë për rishqyrtim lidhur me përshkrimin teknik apo paramasën. Kjo dëshmon qartë se Dosja e Tenderit ka qenë e kuptueshme dhe e pranueshme për Operatorët Ekonomik.

Pretendimi i AK-së se pozicioni 2.2 i grupacionit 2 krijon obligim financiar për AK-në është interpretim i gabuar dhe i pabështetur në dokumentacionin e tenderit. Operatori Ekonomik ka ofertuar në bazë të paramasës së publikuar nga vetë Autoriteti Kontraktues dhe nuk mund të bartë përgjegjësi për paqartësitë eventuale të hartuara nga Njësia Kërkuese apo AK.

Gjithashtu, AK në mënyrë të pabazuar pretendon se pagesat për largimin e automjeteve që tejkalojnë afatin prej 24 orësh do të mbuloreshin nga buxheti i komunës. Në fakt, natyra e këtij shërbimi dhe praktika e zakonshme e zbatimit nënkupton se kostot për shkelësit duhet të faturohen ndaj pronarëve të automjeteve dhe jo ndaj Autoritetit Kontraktues. Një interpretim i tillë nuk mund të përdoret si bazë ligjore për anulimin e procedurës së prokurimit pas hapjes dhe rivlerësimit të ofertave.

Po ashtu, pretendimet për “diskrepancë” në mes të grupacioneve 2 dhe 3 lidhur me peshimin dhe kohëzgjatjen e kontratës janë të paqëndrueshme, pasi Operatori Ekonomik ka ofertuar konform sasive dhe paramasave të publikuara nga vetë AK. Nëse AK ka bërë vlerësim të gabuar të sasive apo të nevojave reale për periudhën 12 mujore, kjo nuk mund të bartet si përgjegjësi tek Operatori Ekonomik.

Tutje, pretendimi se deklarata e Operatorit Ekonomik ka qenë në kundërshtim me çmimet e vendosura në paramasë nuk është argumentuar me asnjë bazë konkrete apo dispozitë specifike të Dosjes së Tenderit, rrjedhimisht mbetet deklarim i përgjithshëm dhe i pamjaftueshëm për të justifikuar anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, konsiderojmë se anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë në kundërshtim me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit, si dhe pa një bazë të mjaftueshme ligjore dhe faktike. Për këtë arsye, kërkujmë që vendimi për anulim të anulohet dhe aktiviteti i prokurimit të rikthehet në rivlerësim në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Kjo dëshmon se përmbajtja e Dosjes së Tenderit ka qenë e kuptueshme dhe e pranueshme për Operatorët Ekonomik në momentin e ofertimit. Për më tepër, të gjithë Operatorët Ekonomik kanë ofertuar çmim për pozitën përkatëse në paramasë, çka nënkupton se specifikimi teknik ka qenë i trajtuar dhe i interpretuar në mënyrë të njëjtë nga pjesëmarrësit në procedurë.

Pretendimi i Autoritetit Kontraktues se ky pozicion do të krijonte obligim financiar shtesë për komunën pas realizimit të kontratës paraqet çështje të planifikimit të brendshëm dhe hartimit të kërkesës nga njësia kërkuese, e jo një bazë ligjore për anulimin e procedurës së prokurimit pas hapjes dhe vlerësimit të ofertave. Gabimet eventuale në përgatitjen e paramasës nuk mund të transferohen në dëm të Operatorëve Ekonomik, të cilët kanë vepruar në përputhje me Dosjen e Tenderit dhe kërkesat e publikuara nga vetë Autoriteti Kontraktues.

Gjithashtu, anulimi i procedurës në këtë fazë cenon parimet themelore të Ligjit për Prokurim Publik, përkatësisht parimin e trajtimit të barabartë, transparencës dhe proporcionalitetit, pasi Operatorët Ekonomik kanë investuar kohë dhe mjete për përgatitjen e ofertave bazuar në kërkesat zyrtare të publikuara nga Autoriteti Kontraktues.

Andaj, konsiderojmë se anulimi i aktivitetit të prokurimit është i pabazuar dhe në kundërshtim me parimet dhe dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, për shkak se arsyet e paraqitura lidhen me mangësi të brendshme në hartimin e specifikimeve nga Autoriteti Kontraktues dhe jo me rrethana objektive që do ta bënë të pamundur vazhdimin e procedurës së prokurimit.

Ky pretendim i Autoritetit Kontraktues nuk qëndron dhe është i pabazuar si në aspektin faktik, ashtu edhe në aspektin juridik, për arsye se gjatë gjithë fazës së tenderimit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për sqarim nga asnjë Operator Ekonomik lidhur me paramasën apo specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit. Gjithashtu, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për interpretim të dokumentacionit të tenderit dhe nuk është ngritur asnjë paqartësi lidhur me përshkrimin teknik apo me pozitën përkatëse në paramasë. Asnjë Operator Ekonomik nuk ka pretenduar gjatë afatit të tenderimit se ekziston paqartësi, hamendësim apo formulim konfuz në dokumentacionin e tenderit.

Për më tepër, as vetë Autoriteti Kontraktues nuk e ka konsideruar dokumentacionin e tenderit si të paqartë gjatë fazës së publikimit të aktivitetit, gjatë fazës së vlerësimit fillestar apo në vendimin e parë për dhënie të kontratës, ku oferta jonë është vlerësuar si e përgjegjshme dhe ekonomikisht më e favorshme. Kjo dëshmon qartë se dokumentacioni i tenderit ka qenë i qartë dhe i zbatueshëm për të gjithë Operatorët Ekonomik.

Vetëm pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim nga një Operator Ekonomik me ofertë më të lartë, Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar qëndrimin e tij dhe ka vendosur anulimin e tërë

procedurës së prokurimit. Ky veprim tregon qartë se nuk ka ekzistuar asnjë hamendësim real në treg dhe as ndonjë paqartësi objektive në dokumentacionin e tenderit, por se arsyetimi për anulim është ngritur vetëm pas përfundimit të procesit të rivlerësimit.

Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar gjithashtu se nuk posedon kapacitete financiare që për çdo automjet të parkuar mbi 24 orë të marrë përsipër pagesën nga buxheti komunal. Edhe ky arsyetim është tërësisht hipotetik dhe i pabazuar, sepse pozicioni në fjalë nuk nënkupton domosdoshmërisht barrë financiare direkte për Autoritetin Kontraktues. Përkundrazi, AK ka të drejtë ligjore dhe administrative të aplikojë gjopa apo penalitete ndaj pronarëve të automjeteve, ndërsa me të njëjtën shumë mund të mbulohet edhe shërbimi i largimit nga Operatori Ekonomik.

Tutje, duhet theksuar se Operatori Ekonomik nuk ka kompetencë ligjore për të shqiptuar gjopa apo masa ndëshkuese ndaj personave që shkelin këtë rregull. Vendosja e gjobave dhe marrja e vendimeve administrative është kompetencë ekskluzive e Autoritetit Kontraktues dhe organeve përkatëse përgjegjëse. Në këtë rast, do të duhej që Autoriteti Kontraktues fillimisht të vendosë gjobën apo masën përkatëse ndaj pronarit të automjetit, ndërsa më pas, me kërkesë apo autorizim të AK-së, Operatori Ekonomik të bëjë largimin e automjetit deri në pllac. Kjo për arsye se Operatori Ekonomik nuk ka asnjë kompetencë të pavarur për të larguar automjete pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues, por ka vetëm të drejtën dhe obligimin për të zbatuar kërkesat dhe autorizimet e lëshuara nga AK.

Prandaj, pretendimi se Autoriteti Kontraktues do të pësojë dëm financiar mbetet vetëm një supozim hipotetik dhe jo një fakt i mbështetur në dokumentacionin e tenderit apo në ndonjë analizë konkrete financiare.

Po ashtu, edhe nëse Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se ekziston ndonjë paqartësi administrative apo teknike lidhur me deklaratën e dorëzuar nga ana jonë, anulimi i tërë procedurës përbën masë të tepruar, joproporcionale dhe në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik, sidomos në rrethanat kur:

- oferta jonë ka qenë oferta me çmimin më të ulët;
- ne jemi shpallur fitues pas vlerësimit fillestar;
- nuk ekziston asnjë shkelje thelbësore e Dosjes së Tenderit;
- dhe Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar asnjë sqarim shtesë para marrjes së vendimit për anulim.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim që fillimisht të aplikojë masa më proporcionale dhe më pak kufizuese, siç janë: kërkesa për sqarime shtesë, verifikimi administrativ apo rivlerësimi i ofertës, e jo anulimin e tërë procedurës së prokurimit.

Në paramasë është vendosur çmimi prej 30 EUR, i cili është plotësisht në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe nuk tejkalon kufirin maksimal të lejuar. Rrjedhimisht, nuk ka ndryshim të substancës ekonomike të ofertës, nuk ka ndryshim të çmimit total të ofertës dhe nuk është shkaktuar asnjë dëm ndaj Autoritetit Kontraktues apo Operatorëve të tjerë Ekonomikë.

Për më tepër, vetë fakti që Autoriteti Kontraktues fillimisht e ka vlerësuar ofertën tonë si të përgjegjshme dhe na ka shpallur fitues krijon besim legjitim tek ne si Operator Ekonomik se

oferta jonë ka qenë në përputhje me kërkesat e tenderit dhe se procedura është zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe ligjore. Ndryshimi i mëvonshëm i qëndrimit të Autoritetit Kontraktues, pa ndonjë bazë të re faktike apo juridike, përbën veprim arbitrar dhe në kundërshtim me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë në procedurat e prokurimit publik.

Në këto rrethana, anulimi i procedurës cenon drejtpërdrejt:

- parimin e proporcionalitetit;
- parimin e trajtimit të barabartë të Operatorëve Ekonomik;
- sigurinë juridike dhe besimin legjitim;
- si dhe ekonomicitetin dhe efikasitetin e shpenzimit të parasë publike.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit është i pabazuar, arbitrar dhe në kundërshtim me dispozitat dhe parimet themelore të Ligjit për Prokurim Publik, andaj kërkojmë anulimin e këtij vendimi dhe vazhdimin e procedurës së prokurimit në përputhje me vlerësimin fillestar dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkitazi me ofertën tonë, prandaj duhet shqyrtuar edhe njëherë ofertën tonë me të gjitha dëshmitë e ofruara. Duke pasur parasysh sqarimet dhe dëshmitë në lidhje me këtë tender, kuptohet qartë se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 43.5 dhe 43.7 të Rregullores nr. 001/2022 të Prokurimit Publik.

Anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit e kuptojmë si tendence diskriminuese ndaj kompanisë tonë, pasi që realisht është dashur të shpallemi fitues të kësaj kontrate sipas vendimit të parë të AK-së sepse i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht jemi ofertuesi me çmimin më të lirë se të gjithë ofertuesit tjerë.

Duke i bazuar në të gjitha sqarimet e lartcekura dhe në dëshmitë e kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të LPP-së, e ku shkruhet qartë se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

### **VENDIM**

**APROVOHET**, si e bazuar ankesa e OE **GASHI EG SH.P.K**

**ANULOHET** njoftimi dhe vendimi i AK-së për anulimin e AP dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM**, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim, ankesave etj. në vlerë prej 1,000.00 euro.
---

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*